

26 janar 2026,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.25/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB Vëllaznimi për regjistrimin e lojtarit Orges Shatri te KB Istogu me licencë te dyfishtë jashtë afatit kalimtar.
- II. Pas shqyrtimit të kësaj kërkeje dhe në bazë të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, Komisioni i Garave REFUZON kërkesën e KB Vëllaznimi për lejimin e regjistrimit të lojtarit Orges Shatri.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

ARSYETIM


Gjatë vendimmarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.25/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Klubi KB Vëllaznimi ka paraqit kërkesë për regjistrimin e lojtarit Orges Shatri si lojtar **me licencë te dyfishtë**.
- (b) Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit të të dhënave zyrtare në sistemin e Federatës së Basketbollit të Kosovës, rezulton se lojtari ka kontratë aktive me KB Istogu, Komisioni konstaton se kërkesa nuk plotëson kushtet e përcaktuara në rregulloret në fuqi, për arsyet në vijim: ***Në përputhje me nenin 33 të Rregullores së Regjistrimit dhe Kalimit të Lojtarëve të FBK-së, licenca e dyfishtë mund të lëshohet vetëm brenda afateve të përcaktuara, përkatësisht deri 24 orë para fillimit të pjesës së parë apo të dytë të kampionatit. Afati kalimtar për edicionin garues 2025/2026 ka përfunduar më 14 janar 2026, çka përbën pengesë ligjore për regjistrimin e lojtarit si lojtar me licencë të dyfishtë.***
- (c) Po ashtu, në përputhje me parimin e sigurisë juridike dhe integritetit të garave, të sanksionuar në Rregulloren Disiplinore dhe aktet nënligjore të FBK-së, Komisioni i Garave është i obliguar të refuzojë çdo kërkesë që bie ndesh me afatet e parapara në rregullore ose që cenon zbatimin e barabartë dhe korrekt të dispozitave garuese.
- (d) Andaj, Komisioni i Garave Vendosi që kërkesa për regjistrimin e lojtarit Orges Shatri **të refuzohet**.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës**KËSHILLË JURIDIKE:**

Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.